



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 30 janar 2015, në orën 13:00,
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Duda Balje, Naim Fetahu, Adem Grabovci, Bali Muharremaj dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Ali Sadriu, Fatmir Limaj, dhe Synavere Rysa

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e komisionit

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Albert Krasniqi dhe Gent Gjikoili KIPRED, Sanije Berisha OSCE, Ramazan Islami GIZ dhe Qendresa Mulaj ZAP.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- A jeni për këtë rend dite, a ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës. Të gjithë u pajtuan me rendin e ditës.

Kryetari - *Konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa asnjë ndryshim.*

Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetari- theksoi se sekretaria e KMFP ka përgatitur një draft plan të punës për vitin 2015, sipas objektivave dhe aktiviteteve që pritet ti ketë KMFP gjatë vitit 2015. Kuptohet sipas fushëveprimit që ka komision. Sipas planit të punës së përgatitur pritet që gjatë vitit të kemi në monitorim dhe shqyrtim raportet e auditimi. Mendojmë që të kemi grupe punuese për të monitoruar institucione të veçanta. Me këtë hapi diskutimin.

Duda Balje- jemi në dijeni që Kryetari i Kuvendit ka kërkuar që të përgatiten planet e punës së komisioneve dhe ato plane duhet paraprakisht të aprovohen në komisionet gjegjëse të Kuvendit, ku më pastaj përgatitet plani i përgjithshëm i punës së Kuvendit. Përveç planit të punës është e nevojshme të përgatiten edhe planet financiare të sektorëve të veçanta. Për këtë e falënderojë edhe stafin e komisionit që ka përgatitur një plan të tillë.

Adem Grabovci- sa i përket formimit të grupeve bazuar në planin e punës, mendoje se është mire të lihen në mënyre të përgjithësuar sepse kjo mund të ndryshojë gjatë vitit. Ne si komision mund të kërkojmë nga ZAP gjatë vitit të kërkojmë auditime dhe raporte të veçanta. Për momentin nuk është mirë të fokusohemi në një raport apo në një qeshje, plani i punës së komisionit duket të jetë i përgjithësuar dhe varësisht sipas nevojës i shqyrtojmë raportet e Auditimit, pse jo edhe rekomandimet që dalin nga këto raporte.

Bali Muharremaj- Unë e falënderojë stafin për punën që ka bërë në përgatitjen e planit të punës së KMFP për vitin 2015. Nuk mendojë se tani mund të themi se cilat raporte të auditimit do ti shqyrtojmë gjatë vitit, mirëpo NE si komision do ti shqyrtojmë ato raporte të cilat kanë opinion jo të mira të auditimit. Mendojë se plani i punës së komisionit duhet të aprovohen në parim sot ashtu siç është përgatitur nga stafi, dhe në mbledhjen e radhës të marrim vendimin final.

Adem Grabovci- kemi një perceptim negativ në vend për sa i përket koncepteve në shqyrtimin dhe analizimin e shfrytëzimit të parasë publike. Ne duhet të zhveshim veten nga petku politik dhe se kemi shumë punë për të bërë në këtë komision. Dëshirojë të theksoi se do ta keni mbështetjen time në këtë drejtim. Po të njëjtën gjë do ta kërkoja nga secili deputet i këtij komisioni.

Handar Beqa- Unë pajtohen që të përkrahet plani i punës së komisionit ashtu siç është dorëzuar nga sekretaria e KMFP, nëse kemi komente apo rekomandime në këtë drejtim ne mundemi deri të martën ti paraqesim dhe ti inkorporojmë në raportin final. Unë kam edhe një pyetje teknike sa i përket zgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm dhe se kjo lidhet me planin e punës së KMFP?

Kryetari- Nuk besojë se procesi i zgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm është në fushën e KMFP kjo do të vendoset pas përgjegjëjes që do ta kemi nga Sekretari i Kuvendit z. Ismet Krasniqi. Atëherë nëse pajtohem draft-planin e punës së komisionit po e huthmi në votim. Me pajtim me të gjithë deputetët e pranishëm votuan pro draft- planit të punës së komisionit për vitin 2015.

Përfundim

Aprovohet në parim draft-planin e punës së KMFP për vitin 2015.

Kryetari i komisionit, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi